



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA Durrës  
**NDËRMARRJA RRUGA Durrës**

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të V.K.M Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar, parashikohet se:

1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.
2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit.

Në zbatim të nenit të sipërpërmendur, Njësia e Prokurimit gjykon se kjo kontratë nuk mund të ndahet në lote pasi kemi të bëjmë me të njëjtën natyrë mallrash, në funksion të një qëllimi, i shërben te njëjtit qëllim për te cilin ato prokurohen dhe perbejne artikuj homogjenë që në thelb i përkasin të njëjtës kategori. Pra nga ana teknike dhe organizative është e nevojshme kryerja e furnizimit pa e ndarë procedurën në lote.

Ndarja në lote do të sillte vështirësi për Autoritetin Kontraktor përfitues për të zbatuar disa kontrata për shkak të arsyeve teknike dhe organizative të përmendura, kjo procedurë për vetë rendësinë dhe specifikat e veçanta që ka realizimi i këtij furnizimi si dhe referuar faktit se kemi të bëjmë me llojin e mallrave, gjykojmë se realizimi i procedurës në një kontratë të pa ndarë në lote është një veprim i drejtë, në përputhje me frymën e legjislacionit të prokurimit publik, që do të shoqërohej me mirëorganizimin e operatorit për sigurimin e mallit në kohë.

Nga ana tjetër referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar neni 2 prashikohet shprehimisht se: “Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të rrisë eficientësinë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar neni 14, Operatorët ekonomikë, parashikohet shprehimisht se:

1. Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizikë ose juridikë.
2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti

kontraktor nuk duhet t'i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje.

Autoritetet ose entet kontraktore mund t'u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t'u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës.

3. Rregullat për mënyrën e plotësimit të kriterëve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

Referuar sa më sipër legjislacioni i prokurimit publik njeh gjithashtu të drejtën e shoqërive për t'u bashkuar për të përmbushur një kontratë prokurimi, në kushtet kur kjo kontratë nuk mund të realizohet nga një operator ekonomik.

Mos ndarja në lote e procedurës së prokurimit, nuk e kufizon konkurrencën, pasi kriteret e hartuara ne DST janë gjithëpërfshirëse, që u jepet hapësirë dhe mundësi të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar për tu bërë pjesë e procedurës të sipërcituar.